

# FLETËNOTIM OCENJIVAČKI LIST

KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS • SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA

I - VI / 2011



Gusht / Avgust  
2011

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë ato të KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin ato të donatorëve.

## PERSONELI

**Ismet KRYEZIU** - Drejtor Ekzekutiv  
email: [ikryeziu@kdi-kosova.org](mailto:ikryeziu@kdi-kosova.org)

**Vjollca VOGËL** - Menaxhere e administratës dhe financave  
email: [vjollca@kdi-kosova.org](mailto:vjollca@kdi-kosova.org)

**Leonora CIKAJ** - Asistente për administratë dhe financa  
email: [lciakaj@kdi-kosova.org](mailto:lciakaj@kdi-kosova.org)

**Donjeta DRESHAJ** - Asistente për administratë dhe financa  
email: [ddreshaj@kdi-kosova.org](mailto:ddreshaj@kdi-kosova.org)

**Arsim Gjinovci** - IT & Design  
email: [agjinovci@kdi-kosova.org](mailto:agjinovci@kdi-kosova.org)

## PROGRAMI: DEMOKRATIZIMI DHE PRAKTIKAT PARLAMENTARE

**Driton SELMANAJ** - Menaxher i programit  
email: [dselmanaj@kdi-kosova.org](mailto:dselmanaj@kdi-kosova.org)

**Isuf ZEJNA** - Asistent i projektit  
email: [izejna@kdi-kosova.org](mailto:izejna@kdi-kosova.org)

**Ganimete HESETI** - Vëzhguese e parlamentit  
email: [gheseti@kdi-kosova.org](mailto:gheseti@kdi-kosova.org)

## PROGRAMI: QEVERISJA LOKALE DHE PJESËMARRJA QYTETARE

**Kreshnik BASHA** - Koordinator  
email: [kbasha@kdi-kosova.org](mailto:kbasha@kdi-kosova.org)

**Naim CAHANAJ** - Koordinator  
email: [ncahanaj@kdi-kosova.org](mailto:ncahanaj@kdi-kosova.org)

## PROGRAMI: TRANSPARENCA DHE ANTIKORRUPSIONI

**Merita MUSTAFA** - Menagjere e programit  
email: [mmustafa@kdi-kosova.org](mailto:mmustafa@kdi-kosova.org)

**Enis XHEMAILI** - Kryesues i hulumtimit  
email: [exhemaili@kdi-kosova.org](mailto:exhemaili@kdi-kosova.org)

**Besnik RAMADANAJ** - Asistent i projektit  
email: [bramadanaj@kdi-kosova.org](mailto:bramadanaj@kdi-kosova.org)

**Natyra KASUMAJ** - Koordinatore  
email: [nkasumaj@kdi-kosova.org](mailto:nkasumaj@kdi-kosova.org)

## PROGRAMI: ZGJEDHJET E LIRA DHE TË DREJTA

**Liridon SELMANI** - Menaxher i programit  
email: [lselmani@kdi-kosova.org](mailto:lselmani@kdi-kosova.org)

## NOTIMI

4

Vlerësimet e paraqitura në këtë fletënotim janë të bazuara në monitorimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare, mbledhjeve të komisioneve parlamentare, materialeve të publikuara në faqen elektronike të Kuvendit të Republikës së Kosovës, bisedat e drejtpërdrejtë me deputetët si dhe personelin mbështetës të Kuvendit. Deputetët e Kuvendit të Kosovës dhe subjektet politike janë notuar në mënyrë individuale në kategori të caktuara të cilat reflektojnë performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

## KATEGORITË

KDI në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe subjekteve politike në kategoritë të paraqitura në vijim:

1. Pjesëmarrja në diskutim;
2. Pjesëmarrja në diskutim në emër të Grupit Parlamentar;
3. Ngritura e çështjeve apo propozimeve;
4. Ngritura e çështjeve apo propozimeve urgjente;
5. Propozimet për amendamente;
6. Nismat legislative;
7. Kërkesat për interpelancë;
8. Pyetjet parlamentare;
9. Gjuha Jo-parlamentare;

## SHTYLLAT E ANALIZËS

Aspekti i përgjithshëm i punës së Kuvendit është vlerësuar në bazë të shtyllave të paraqitura në vijim:

- Seancat plenare;
- Komisionet parlamentare;
- Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë;
- Implementimi i Planit të Punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

## PËRMBAJTJA

• Sesioni pranveror i Legjislaturës së IV-të të Kuvendit të Kosovës.....	5
• Seancat plenare.....	5
• Komisionet parlamentare.....	7
• Mbikëqyrja parlamentare.....	9
• Pyetjet Parlamentare.....	9
• Interpelancat parlamentare.....	12
• Dëgjimet Publike .....	12
• Monitorimi i Zbatimit të Ligjeve.....	13
• Implementimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2011.....	14
• Transparenca e Kuvendit.....	16
• Rekomandime.....	17
• Tabela dhe analiza .....	18

## Sesioni pranveror i Legjislaturës së IV-të të Kuvendit të Kosovës

### • Seancat plenare

Legjislatura e IV-të e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e cila doli si rezultat i zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 12 dhjetorit 2010, është konstituuar në seancën e 21 shkurtit 2011. Që nga konstituimi e deri në fund të qershorit 2011 Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 20 seanca plenare, prej tyre 17 të rregullta 2 të jashtëzakonshme si dhe 1 komemorative.

Kjo Legjislaturë, qysh në fillim të mandatit është ballafaquar me një proces të ndërlikuara, siç ishte rasti gjatë zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Kosovës, ku Gjykata Kushtetuese mënyrën e zgjedhjes së Presidentit nga ana e Kuvendit, e vlerësoi si kundër kushtetuese. E gjithë kjo situatë kishte ndodhur pas vendimit të partive në koalicion që kandidat i vetëm për postin e presidentit ishte z.Behxhet Pacolli. Në dy raundet e para në të cilat parashihet që Presidenti të zgjidhet me dy të tretat e të gjithë deputetëve të Kuvendit, nuk u arrit të sigurohen votat e mjaftueshme për të zgjedhur Presidentin. Duke parë këtë situatë PDK kërkoi mocion procedural përkatësisht pauzë për tu konsultuar brenda grupit të vetë parlamentar pasi që ishte evidente se disa deputet nuk votonin sipas linjës partiake, ndërkohë që partitë politike opozitare e kishin braktisur seancën. Edhe pse ata kërkuan këtë mocion, deputetët filluan të dalin me iniciativën e kryetarit të PDK-së Hashim Thaçi duke mos pritur fare mendimin e Kryetarit të Kuvendit apo hedhjen në votim të propozimit. Në këtë rast kryetari konstatoi se po shkelet Kushtetuta dhe Rregullorja e punës, pasi që kjo pauzë po bëhej për të ushtruar presion mbi deputetët e PDK-së. Pas kësaj pauze, ishte raundi përfundimtar i tretë për të votuar dhe pauza kishte bërë që skeptikët të bindeshin e duhej votuar pro Behxhet Pacollit për President. Në këtë raund Pacolli u zgjedh me 62 vota për, 4 kundër dhe 1 abstenim. Megjithatë jo më shumë se 35 ditë nga zgjedhja e z. Pacolli, President i Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi atë duke e konsideruar mënyrën e zgjedhjes së tij nga ana e Kuvendit, si antikushtetuese. Gjykata Kushtetuese e mori këtë vendim, pas ngritjes së kësaj çështjeje nga deputetët e LDK-së dhe AAK-së.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese se zgjedhja e Presidentit të Republikës së Kosovës, Behjet Pacolli ishte jo-kushtetuese, Kuvendi i Kosovës në një seancë të jashtëzakonshme, më 7 prill zgjodhi Presidentin e ri të Kosovës. Ish-zëvendësdrejtoresha e përgjithshme e Policisë së Kosovës, Atifete Jahjaga qysh në raundin e parë mori shumicën e votave nga parlamentarët e pranishëm në sallë. Presidentja Jahjaga u zgjedh pas marrëveshjes paraprake të arritur ndërmjet tri partive politike: PDK-së, LDK-së dhe AKR-së.

shtjet tjera të rëndësishme që e kanë përcjellur sesionin pranveror të kësaj legjislature janë: Debatë mbi Buxheti për vitin 2011, Privatizimi i PTK-së, Dialogu Kosovë-Serbi, Autostrada Vërmicë – Merdare, Rastet e gjykimeve në Hagë, Masakra në Burgun e Dubravës, Bashkëpunimi me Interpolin, Raportet e Agjensioneve të Pavarura etj.

Po ashtu qysh në fillim të mandatit Kuvendi i Kosovës edhe një herë diskutoj për privatizimin e PTK-së, çështje e cila ishte lënë trashëgim nga legjislatura e kaluar, madje atëbotë ishte vlerësim i përgjithshëm që pikërisht kjo temë ishte ndër shkaqet që qoi në prishjen e koalicionit qeveritar.

Këtë vit Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin për privatizimin e 75% të aksioneve të PTK-së dhe këtë vendim e ka bashkangjitur si aneks në Projektligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2011, përkatësisht në Nenin 4 të këtij Projektligji. Kjo në fakt alarmoi të gjithë, për shkak se Ligji për Ndërmarrjet Publike në Nenin 9, ku flitet për shitjen e aksioneve e thotë qartë se privatizimi mund të bëhet vetëm pasi që vendimi i qeverisë të miratohet në Kuvend me shumicë votash. Ky vendim asnjëherë nuk është miratuar si i tillë në ndonjë seancë plenare, ai vetëm ishte proceduar për diskutim në komisionin përkatës funksional, dhe aty kishte mbetur.

Një ndër çështjet kyçë, që brenda periudhës 4 mujore është trajtuar dy herë në Kuvendin e Kosovës, ka qenë dialogu Kosovë – Serbi. Në seancën e 7 marsit, me kërkesën e Qeverisë së Kosovës, Kuvendi ka debatuar lidhur me procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Grupi parlamentar i PDK-së dhe ai i Vetëvendosjes kishin propozuar nga një rezolutë, njëra në mbështetje të këtij procesi e tjera në kundërshtim të tij. Pas një debati të nxehëtë ishte e qartë se lidhur me këtë temë nuk kishte konsensus brenda grupeve parlamentare andaj u kërkua që deri në një seancë tjeter të përpinqeshin shefat e grupeve parlamentare që të gjenin një version të pranueshmë për të gjithë. Në seancën e datës 10.03.2010 u votua Draft Rezoluta e prezantuar nga shefi i grupit parlamentar të PDK-së Adem Grabovci i cili njoftoi se nuk ka arritur një konsensus me shumicën e shefave të grupeve parlamentare, gjë e cila gjatë votimit u vërejt qartë se nuk u mbështet në formë konsensual.

Po për këtë çështje me 05 maj 2011, me kërkesë të Lëvizjes Vetëvendosje ishte ftuar në interpelancë Kryeministri Hashim Thaqi. Pas një diskutimi të gjatë lidhur me këtë çështje, deputetët votuan për tekstin e mocionit të propozuar për votim nga Lëvizja Vetëvendosje ku thuhej: 1. Të ndërpriten bisedimet me Serbinë, 2. Qeveria të ndërmarrë hapa konkretë për të shtrirë autoritetin e shtetit të Kosovës në të gjithë territorin e saj, veçanërisht në veri, dhe 3. Qeveria e Kosovës të informoj rregullisht, çdo tre (3) muaj Kuvendin e Kosovës, për përpjekjet e saj për të vendosur kontroll në tërë territorin e Kosovës. Deputetët me shumicë votash nuk e miratuan pikën e parë të mocionit të propozuar nga Lëvizja Vetëvendosje për ndërprerjen e bisedimeve me Serbinë, ndërsa me shumicë votash miratuan dy pikat tjera të këtij mocioni.

Kuvendi i Kosovës, edhe pse institucioni më i lartë i vendit, pothuajse i fundit i ka parë marrëveshjet (konkluzat) e arritura në këto bisedime, dhe për këtë arsyе nuk ka pasur ndonjë vlerësim zyrtar dhe gjithçka mbetët e paqartë edhe për sa i përket implementimit të tyre. Duke e ditur rëndësinë e këtij procesi, çdo gjë e cila obligon vendin tonë për të implementuar këto marrëveshje, do të duhej të kalonte nëpërmjet ratifikimit në Kuvendin e Kosovës, pasi kjo gjë është e rregulluar me aktin më të lartë juridik dhe politik të vendit - Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ajo çka është e veçantë për këtë legjislaturë dhe që nuk ka qenë shumë e shprehur në legjislaturat e kaluar është, fjalori i ashpër politik i cili në shumë raste shkonte deri në fyerje dhe akuza personale në mes deputetëve të partive në pushtet dhe atyre opozitare.

Çështjet tjera që e kanë karakterizuar punën e Kuvendit në seanca plenare në këtë periudhë raportuese janë: mos gatishmëria e kabinetit qeveritar për të qenë të pranishëm në seanca plenare kur trajtoheshin çështjet me rëndësi si Raporti i shpenzimeve për Buxhetin e Kosovës

për vitin 2010, Raporti vjetor i Agjencisë Kundër Korruptionit(AKK) për vitin 2010; mos gatishmëria e deputetëve të qëndrojnë në seanca plenare, votimi i deputetëve për kolegët e tyre, fillimi i trajtimit të çështjeve dhe mospërfundimi i tyre (rasti i debatit për SHIK-un) etj.

## Komisionet parlamentare

Komisionet parlamentare përbëjnë shtyllën kryesore në ushtrimin e funksioneve të parlamentit: në funksionin legjislativ, në kontrollin e pushtetit ekzekutiv si dhe në transparentë e qeverisjes dhe të proceseve politike. Komisionet Parlamentare bëjnë shqyrtimin dhe amendamentimin e Projektligjeve, mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjeve, vizita në terren, si dhe mund të merren edhe me çështje të tjera që dalin nga fushë-veprimtaria e tyre. Në praktikat e ndryshme parlamentare legjislaturat kanë të drejtë të formojnë komisione të përhershme dhe komisione të përkohshme parlamentare.

Në Legjislaturën e IV-të, Kuvendi i Kosovës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Rregulloren e Kuvendit, sipas propozimit të Kryesisë së Kuvendit mori vendim për zvogëlimin e numrit të Komisioneve parlamentare nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) sa ishin më parë në 13 (trembëdhjetë), me arsyetimin se zvogëlimi i numrit të komisioneve është bërë për t'i ikur përfshirjes së dyfishtë të deputetëve në komisione dhe racionalizimit të shpenzimeve buxhetore. Nga këto komisione, 4 (katër) janë të përhershme, dhe 9 (nëntë) komisione funksionale.

Brenda komisioneve të përhershme mund të organizohen edhe nën-komisione, që mbulojnë fusha më të ngushta, në të cilat përfshihen vetëm një pjesë e anëtarëve të komisionit. Gjithashtu për çështje të interesit të përbashkët, dy ose më shumë komisione mund të formojnë nën-komisione të përbashkëta. Kjo legjislaturë brenda kësaj periudhe ka formuar 1 nën-komision, Nën-komisionin për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës.

Gjithashtu në këtë legjislaturë janë formuar edhe dy komisione ad-hoc: Komisioni për amandamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe Komisioni për amendamentimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

## Mbledhjet e Komisioneve Parlamentare

Në bazë të Rregullores së Kuvendit të Kosovës dhe praktikes së punës së Komisioneve Parlamentare, të gjitha komisionet kanë hartuar planet e aktiviteteve të tyre për vitin 2011.

Komisionet parlamentare për periudhën mars-qershor 2011, në total kanë mbajtur gjithsej 157 mbledhje prej të cilave 3 kanë qenë dëgjime publike. Komisioni me numrin me të madh të mbledhjeve të mbajtura gjatë kësaj periudhe është Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me gjithsej 18 mbledhje dhe 1 dëgjim publik, pas tij vjen Komisioni për Buxhet dhe Financa me gjithsej 17 mbledhje dhe 1 dëgjim publik. Ndërkaq komisioni me më paku mbledhje të mbajtura gjatë kësaj periudhe është Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim me 8 mbledhje të mbajtura.

Nëse marrim si kahasim vëllimin e punës në bazë të muajve, muaji qershor është muaji ku vërehet një angazhim i shtuar i dinamikës së mbledhjeve të komisioneve parlamentare me gjithsej 52 mbledhje të mbajtura. Kjo dinamik e punës së komisioneve ka qenë si pasojë e intensifikimit të punës për të përbushur sa më tepër planin e punës për përbushjen e sfidave që dalin nga Raporti i Progresit.

Për dallim nga legislatura e kaluar, Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligencë në këtë legjislaturre ka mbajtur të gjitha mbledhjet me dyert e myllura. Përveç dy mbledhjeve orari i të cilave është publikuara në faqen elektronike të Kuvendit, mbledhjet e tjera nuk janë publikuar fare.

	Komisionet	Numri i Mbledhjeve	Datat e mbledhjeve																						
			15 Mar	18 Mar	23 Mar	28 Mar	29 Mar	30 Mar	6 Prill	8 Prill	13 Prill	20 Prill	4 Mai	11 Mai	1 Qer DP	2 Qer	8 Qer	15 Qer	21 Qer	22 Qer					
1	Komisioni për b4xhet dhe f5anca	18																							
2	Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës	9	22 Mar	19 Prill	25 Maj	2 Qer	6 Qer	8 Qer	14 Qer	17 Qer	24 Qer														
3	Komisioni për Legislacion	13	21 Mar	23 Mar	28 Mar	30 Mar	4 Prill	18 Prill	27 Prill	11 Mai	23 Mai	2 Qer	6 Qer	21 Qer	22 Qer										
4	Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri	19	17 Mar	29 Mar	30 Mar	12 Prill	15 Prill	19 Prill	26 Prill	3 Mai	10 Mai	17 Mai	24 Mai	25 Mai	2 Qer	7 Qer	8 Qer	10 Qer DP	14 Qer	21 Qer	28 Qer				
5	Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor	12	14 Mar	21 Mar	30 Mar	12 Prill	3 Maj	10 Maj	23 Maj	30 Maj	2 Qer	6 Qer	15 Qer DP	23 Qer											
6	Komisioni për Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim	8	21 Mar	29 Mar	30 Mar	19 Prill	23 Maj	7 Qer	10 Qer	22 Qer															
7	Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media	11	17 Mar	21 Mar	30 Mar	19 Pril	27 Pril	11 Maj	18 Maj	31 Maj	15 Qer	22 Qer	29 Qer												
8	Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale	12	18 Mar	23 Mar	30 Mar	13 Pril	15 Pril	27 Pril	4 Maj	18 Maj	8 Qer	15 Qer	22 Qer	29 Qer											
9	Komisioni për Punë të Jashtme	10	18 Mar	23 Mar	30 Mar	8 Pril	27 Pril	11 Maj	13 Maj	25 Maj	8 Qer	23 Qer													
10	Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Petacione	9	22 Mar	29 Mar	31 Mar	13 Pril	27 Pril	4 Maj	25 Maj	10 Qer	21 Qer														
11	Komisioni për Integrime Evropiane	9	16 Mar	30 Mar	8 Pril	4 Maj	11 Maj	18 Maj	13 Qer	21 Qer	23 Qer														
12	Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike	14	21 Mar	23 Mar	29 Mar	12 Pril	26 Pril	10 Maj	11 Maj	18 Maj	24 Maj	25 Maj	8 Qer	15 Qer	22 Qer	29 Qer									
13	Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligencë	2	16 Mar	13 Pril																					
14	Nën-komisioni për Mandate, Imunitete dhe Rregullore të Punës	11	6 Pril	20 Pril	26 Pril	27 Pril	10 Maj	17 Maj	26 Maj	1 Qer	7 Qer	8 Qer	28 Qer												

## Mbikëqyrja parlamentare

Një ndër funksionet themelore të Kuvendit të Kosovës është edhe roli mbikëqyrës mbi ekzekutivin e vendit, duke kërkuar nga kabineti qeveritar që të raportojnë për punën e tyre, ti ofrojnë llogaridhënie organit përfaqësues si dhe transparencë për punën e seçilit dikasterë të Qeverisë.

Këtë funksion Kuvendi i Kosovës e realizon përmes instrumenteve të garantuara me Kushtetutë dhe aktet tjera ligjore si pyetjet parlamentare, interpelancat si dhe ftesat për ministrat për të raportuar në mbledhjet e komisioneve parlamentare.

Duhet konstatuar se struktura politike e legjislaturës së IV-të, ka ndryshuar shumë në aspektin pozitiv në kuadër të rolit mbikëqyrës të qeverisë nga ana e Kuvendit të Kosovës. Dallimi shumë relativ në numrat e deputetëve që janë pjesë e koalicionit qeverisës dhe subjekteve politike opozitare, ka bërë që për herë të parë në historinë e re të parlamentit të Kosovës të kemi një pozitë dhe opozitë mjaft të konsoliduar. Kjo ka ndikuar dukshëm në dinamizmin e punës së Kuvendit të Kosovës dhe çka është më e rëndësishmja është rritur roli mbikëqyrës i Kuvendit ndaj qeverisë së Kosovës. Organizimi i dy interpelancave parlamentare si dhe i dy seancave të jashtëzakonshme për të trajtuar çështje të rëndësishme, po ashtu është një element që ndikon në vlerësimin pozitiv për rolin mbikëqyrës të legjislativit ndaj ekzekutivit.

- Pyetjet parlamentare**

Një nga mekanizmat demokratik të mbikëqyrjes parlamentare të Qeverisë nga Kuvendi janë edhe pyetjet parlamentare. Në praktikat parlamentare kjo formë e mbikëqyrjes në masë më të madhe shfrytëzohet nga subjektet politike opozitare, por pa i përjashtuar në raste të caktuara edhe deputetët e pozitës.

### Pyetjet parlamentare sipas çështjeve




Fig 1,  
Paraqitura në përqindje  
e pyetjeve të  
parashtruara sipas  
kategorive<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Vërejtje – pyetjet e paraqitura në grafikon janë vetëm ato të cilat janë lexuar në seanca plenare.

Që nga konstituimi i kësaj legjislature të Kuvendit të Kosovës, në muajin shkurt 2011, e deri në qershor, deputetët kanë parashtruar gjithsej 36 pyetje parlamentare për kabinetin qeveritar. Në përgjithësi, numri më i madh i pyetjeve të deputetëve janë parashtruar nga deputetë të partive opozitare. Ndërkoq që kanë qenë vetëm tre deputetë nga subjektet politike në pushtet nga pozita që kanë parashtruar gjithsej tetë (8) pyetje parlamentare.

Një praktikë e cila po i përcjell të gjitha legjislaturat pa përjashtim është injorimi i pyetjeve parlamentare të deputetëve nga kabineti qeveritar.

#### • **Natyra e pyetjeve të parashtruara**

Fushat që më së shumti kanë zgjuar interesin e ligjvénësve për tu artikuluar në pyetje parlamentare kanë qenë ato sociale dhe shëndetësore, pasuar nga çështjet ekonomike, administratës publike, punët e brendshme etj. Numri më i madh i pyetjeve parlamentare u janë drejtuar ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Nenad Rashic, si dhe ministrit të Shëndetësisë, Ferid Agani, me nga gjithsej pesë (5) pyetje parlamentare. Çështjet politike kanë qenë në rangun e dytë të fokusit të pyetjeve parlamentare, me gjithsejtë 4 sosh, ku tre nga to u janë drejtuar kryeministrat Hashim Thaçi.

Çështjet tjera që kanë pasur fokus gjatë pyetjeve parlamentare kanë qenë: Administrata Publike, çështjet ekonomike, punët e brendshme, tregtia dhe integrimet evropiane, me nga 2 pyetje për secilën fushë. Ndërkakq me nga një pyetje janë trajtuar çështje si: arsimi, drejtësia, kultura, etj.

#### • **Numri i pyetjeve sipas Grupeve parlamentare**

**Grupi Parlamentar i PDK-së** - këtë mandat ka gjithsej (34) deputetë, vetëm tre nga ta kanë shfrytëzuar të drejtën e të bërit pyetje parlamentare, me gjithsej (8) pyetje. Deputeti Arsim Bajrami ka parashtruar (3) pyetje, Njazi Idrizi (3) dhe Salihe Mustafa (2) pyetje.

**Grupi Parlamentar i LDK-së** - ka gjithsej (27) deputetë dhe katër nga këta kanë shfrytëzuar kontrollin parlamentar përmes pyetjeve, me gjithsej (8) pyetje. Lutfi Haziri ka parashtruar gjithsej (4) pyetje, Rita Hajzeraj (2), Afërdita Berisha Shaqiri (1) dhe Salih Morina (1).

**Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes** - ka gjithsej (13) deputetë dhe pesë nga ky numër kanë parashtruar pyetje parlamentare, gjithsej (8). Visar Ymeri e Afrim Kasolli kanë bërë nga (2) pyetje, ndërkakq nga (1) pyetje kanë bërë: Agim Kuleta, Alma Lama, Liburn Aliu dhe Albulena Haxhiu.

**Grupi Parlamentar i AAK-së** - ka gjithsej (11) deputetë, pesë nga ta kanë parashtruar pyetje, gjithsej (10) sosh, grupi parlamentar që ka parashtruar më së shumti pyetje. Time Kadriaj ka parashtruar (5) pyetje, Xhevdet Neziraj (2), Bali Muharremaj (1), Donika Kadaj-Bujupi (1) dhe Teuta Haxhiu (1).

**Grupi Parlamentar i KKR-së** - ka gjithsej (9) deputetë. Ky grup parlamentar që është pjesë e koalicionit qeveritar, nuk e ka shfrytëzuar të drejtën parlamentare për të bërë pyetje për kabinetin qeveritar. Asnjë nga deputetët e këtij grupei nuk e kanë bërë asnjë pyetje.

**Grupi Parlamentar i SLS-së** - me gjithsej 12 deputetë, pjesë e koalicionit qeveritar, po ashtu nuk ka bërë asnjë pyetje parlamentare.

**Grupi Parlamentar i (6+)** - me gjashtë deputetë, po ashtu nuk ka parashtruar asnjë pyetje.

Deputetët pa grup parlamentar që janë gjithsej (6) deputetë, vetëm njëri prej tyre ka bërë pyetje parlamentare. Danush Ademi ka parashtruar të dy pyetjet.

Deputetët që kanë parashtruar më së shumti pyetje janë: Time Kadriaj (5) pyetje, Lutfi Haziri (4) pyetje, Arsim Bajrami (3) pyetje, Njazi Idrizi (3) pyetje, Visar Ymeri (2), Salihë Mustafa (2), Rita Hajzeraj (2), Afrim Kasolli (2), Xhevdet Neziraj (2) dhe me nga një pyetje janë: Afërdita Berisha-Shaqiri, Saloh Morina, Agim Kuleta, Alma Lama, Liburn Aliu, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj Bujupi, Bali Muharremaj dhe Teuta Haxhiu.

**Përqindja e pyetjeve parlamentare sipas GP-ve**




Fig 2, Paraqitura në përqindje e pyetjeve të parashtruara sipas grupeve parlamentare

## • **Interpelanca parlamentare**

12

Interpelancat parlamentare janë një instrument ligjor që përfaqësuesit e popullit ushtrojnë në emër të qytetarëve, për të kontrolluar kabinetin qeveritar në të gjitha segmentet që vlerësohen si të rëndësishme nga ana e deputetëve. Neni 44 paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit i mundëson Kuvendit që një grup parlamentar ose (6) e më shumë deputet mundë të parashtrojnë kërkesë për Interpelancë për të shqyrtuar një çështje, që lidhet me punën e Qeverisë apo të një Ministrie të caktuar.

Në krahasim me legjislaturat e kaluara ku ky instrument është shfrytëzuar minimalisht nga ana e subjekteve politike parlamentare, ky trend në legjislaturën e IV-të, ka fillouar të ndryshojë. Vetëm për periudhën pesë mujore, janë organizuar dy interpelanca parlamentare, që të dyja janë bërë me kërkesë të Lëvizjes Vetëvendosje ku i ftuar në të dy rastet ishte Kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaqi. Interpelanca e parë ishte organizuar në seancën e 05 majit 2011, lidhur me bisedimet Kosovë- Serbi, ndërsa interpelanca e dytë ishte organizuar me 30.06.2011 lidhur me autostradën Vërmicë - Merdare. Rritja e shfrytëzimit të këtij instrumenti të kontrollit parlamentar, tregon përritjen e kërkesës për llogaridhënie dhe transparencë në politikën kosovare.

## • **Dëgjimet Publike**

Procesi i hartimit dhe diskutimit të ligjeve nuk është i mjaftueshëm vetëm përbrenda një komisioni apo vetë deputetëve. Andaj dëgjimet publike janë mekanizëm i Kuventit që u mundësojnë atyre të marrin informata dhe ekspertizë nga grupet e shoqërisë civile, organizatave sektoriale, grupeve të caktuara të interesit apo edhe vetë qytetarët lidhur me projektligjet të cilat janë në hartim. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur vetëm 3 (tri) dëgjime publike, dhe atë vetëm në muajin qershor. Komisionet të cilat kanë organizuar dëgjime publike janë: Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë Tregti dhe Industri (1), Komisioni për Buxhet dhe Financa (1) dhe Komisioni për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor (1).

KDI konsideron se numri i dëgjimeve publike për këtë periudhë kohore ka qenë tejet i vogël. Kërkesa e OSCH-ve (Organizatat e Shoqërisë Civile) në vazhdimësi ka qenë që numri i konsultimeve të rritet, fatkeqësisht nëse e krahasojmë me legjislaturën e kaluar ku vetëm gjatë sesionit pranveror janë organizuar rreth 17 dëgjime publike, ky trend i punës së kësaj legjislature është mjaft dekurajuese në përfshirjen sa më të gjërë në procesin e konsultimeve publike.

## • Monitorimi i Zbatimit të Ligjeve

Komisionet parlamentare, një ndër detyrat me rëndësi të madhe të përcaktuar me Rregulloren e Punës, kanë edhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve. Këtë mandat i cili nuk filloj punën efektive deri në muajin mars, pothuajse të gjitha komisionet parlamentare kanë paraparë në planet e tyre të punës edhe monitorimin e zbatimit të ndonjë ligji që del nga fushë-veprimtaria e tyre. Edhe pse ishin planifikuar me kohë të monitorohen këto ligje, deri në fund të muajit qershori, asnjë komision nuk ka arritur të përmbyll këtë proces dhe seancës t'i paraqes raportin me rekomandime nga ky monitorim.

Gjithsesi koha e shkurtët dhe obligimet e shumta të trashëguara nga legjislatura e kaluar për shqyrtim të projektligjeve, janë disa nga shkaqet që kjo ka ndodhur, edhe pse nuk duhet përjashtuar faktin se komisionet nuk po tregojnë interes për monitorimin e ligjeve duke pasur parasysh angazhimin që kërkon ky proces në terren.

Edhe pse nëntë (9) komisione parlamentare e kanë filluar procesin e monitorimin e zbatimit të dhjetë (10) ligjeve, asnjëri prej tyre nuk e ka përfunduar këtë proces deri në këtë periudhë raportuese. Duke e krahasuar me gjashtë mujorin e legjislaturës së kaluar, kahja është më progresive, mirëpo është dukshëm larg nevojave që Kuvendi të marr rol më domethënës në kontrollin ndaj pushtetit ekzekutiv në mënyrë që të forcohet implementimi i ligjeve të miratuara nga ky organ. Në anën tjeter janë pesë (4) komisione parlamentare të cilat nuk kanë filluar të monitorojnë zbatimin e ndonjë ligji, mirëpo planifikojnë që këtë ta bëjnë në sesionin e ardhshëm parlamentar.

Komisionet të cilat janë në proces të monitorimit të zbatimit të ligjeve janë: 1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, 2. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, 3. Komisioni për Bujqësi Pylltari, Zhvillim Rural dhe Mjedis, 4. Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, 5. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, 6. Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, 7. Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, 8. Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, Komisioni për Punë të Jashtme.

Komisionet të cilat nuk kanë filluar monitorimin e zbatimit të as një ligji: 1. Komisioni për Integrimë Evropiane(ky Komision monitoron pjesërisht Ligjin për prokurimin publik), 2. Komisioni për Komunitete dhe Kthim,3. Komisioni për Mbikëqyrjen e Agjensionit Kosovar për Inteligjencë, 4. Komisioni për Legjislacion.

Deri në fund të gjashtëmujorit të parë të këtij viti, Kuvendi me planin e vetë të punës ka paraparë që të përfundojnë së monitoruari zbatimi i dy ligjeve, dhe që raportet nga monitorimi të dalin për diskutim dhe miratim në seancë plenare. Asnjë nga këto dy ligje nuk ka përfunduar se monitoruari brenda këtij afati të përcaktuar në planin e punës, dhe nuk janë aprovuar raportet e monitorimit të tyre.

Po ashtu është për t'u analizuar fakti se si komisionet parlamentare bëjnë përzgjedhjen se cilat ligje duhet monitoruar. Shpeshherë përzgjedhja e prioriteteve për monitorim nuk bëhet mbi bazën e nevojave reale që dalin nga terreni, por mbi vendimet e

atypërathyshme të kryetarëve të komisioneve të Kuvendit. Kuvendi do të duhej të përcaktonte shtyllat e përhershme të monitorimit të zbatimit të ligjeve, për të përcjellë në vazhdimësi progresin në zbatimin e ligjeve, në mënyrë që të ketë të dhëna vetjake për sa i përket punës së institucioneve në vend. Këto të dhëna Kuvendi do të mund t'i shfrytëzonte më pas për të thirrur anëtarët e kabinetit qeveritar për raportim përballë komisioneve apo seancës plenare. Deri më tani monitorimi i ligjeve ka qenë i fragmentuar, dhe zakonisht për çështje të rëndësisë terciare, andaj edhe monitorimi si mekanizëm ka qenë i dobët në ndryshimin e gjendjes në këtë aspekt.

### • **Implementimi i Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2011**

Kuvendi i Kosovës edhe pse me vonesë, në prill të këtij viti ka miratuar planin e vetë të punës duke u bazuar pothuajse në tërësi në Strategjinë Legjislative të Qeverisë së Kosovës. Në këtë plan të punës Kuvendi ka planifikuar që të miratoj 148 projektligje dhe 15 akte të tjera, në të dy leximet për vitin 2011, prej të cilave rreth 53 projektligje janë të planifikuara të miratohen deri në fund të muajit qershor. Ndërsa nga këto 53 projektligje, 26 projektligje është dashur të miratohen në të dy leximet dhe të jenë të gatshme për t'i dekretuar Presidenti i Republikës. Ky plan është tejet ambicioz dhe në kundërshtim me kapacitetet e vetë Kuvendit të Kosovës për të mundësuar që këto projektligje të shqyrtohen në përputhje me procedurat normale të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit të Kosovës. Për këtë nguti arsyetim ç'do herë është përdorur Raporti i Progresit të Komisionit Evropian, si dhe Plani për Përbushjen e Sfidave që dalin nga ky rapport. Si rezultat i këtij shqyrtimi të shpejtë shumë ligje ende pa filluar zbatimin e tyre, duhet të kthehen në fazën e plotësimit apo ndryshimit të tyre, pasi nga Kuvendi dalin me anomali të cilat e bëjnë të pa zbatueshëm si akt.

Kuvendi i Kosovës deri në muajin qershor ka arritur që të miratoj 21 projektligje në leximin e parë, ndërsa vetëm 7 në të dy leximet. Kjo shifër është dukshëm larg nga ajo që ka planifikuar në fillim të këtij mandati Kuvendi i Kosovës. Në fakt shumë akterë i kanë tërhequr vërejtjen Kuvendit të Kosovës se 163 projektligje është e pa mundur të trajtohen brenda një viti në Kuvendin e Kosovës. Edhe këtë herë si në të kaluarën Kuvendi po dëshmohet se planifikon dobët planin e vet të punës, dhe se çdo fillim të vitit synon shumë, ndërsa dinamika e punës tregon se as një herë nuk arrin të plotësoj më tepër se 1/3 e asaj që ka planifikuar.

Sponsorimi i projektligjeve, në tërësi është planifikuar të bëhet nga Qeveria e Kosovës, dhe në këtë plan nuk janë paraparë shqyrtimet e raporteve të agjencive të pavarura veç e veç, duke bërë që këto shqyrtimet të bëhen ad-hoc, duke mos patur një orar dhe dinamikë se deri kur, cili report duhet të përmbyllët së shqyrtuar, gjë e cila përcaktohet me ligjet themelitore të këtyre agjencive.

Është evidente se Qeveria e Kosovës nuk i ka proceduar me kohë të gjitha projektligjet ashtu siç është paraparë me Strategjinë e saj Legjislative, mirëpo kjo nuk është aspak çështje e panjohur për Kuvendin, i cili vit pas viti është përballur me këtë çështje dhe duket se nuk janë nxjerr mësimet thelbësore, se Kuvendi duhet të fuqizoj rolin e vet në procesin e hartimit të Legjislacionit në të gjitha fazat dhe jo të shndërrrohet në një organ i cili vetëm i voton aktet legjislative.

## Realizimi i planit të punës deri me 30 qershor




Fig 3, Paraqitura në numra e Projektligjeve të planifikuara për miratim në lexim të parë dhe të dytë, si dhe miratimi i tyre në Kuvend në periudhën shkurt - 30 qershor 2011.

## Programi vjetor i punës së Kuvendit




Fig 4, Paraqitura në numra dhe përqindje e Projektligjeve të planifikuara për miratim në të dy leximet në periudhën shkurt - dhjetor 2011.

Kuvendi ka paraparë në këtë plan të punës që të miratoj edhe disa akte të tjera, si Rregulloren e re të punës së Kuvendit, raporte të monitorimit të ligjeve, Planin e veprimit të Kuvendit për Integrime Evropiane etj. Edhe në këtë pikë situata nuk është substancialisht më e mirë pasi brenda këtij afati Kuvendi nga shtatë akte të parapara, ka miratuar vetëm katër dhe nuk ka arritur të miratoj ende Rregulloren e re të punës.

Kuvendi i Kosovës duhet të punoj me dinamikë të shtuar në mënyrë që deri në fund të vitit të arrij të aprovoj të paktën gjysmën e këtyre projektligjeve të cilat janë paraparë

me planin e punës, pasi që në start objektivat kanë qenë shumë optimiste. Me gjasë ky plan i punës do të rishikohet në sesionin e ardhshëm dhe një numër i madh i projektiljeve do të largohen nga lista, me çka do të vërtetohet se planifikimet fillestare kanë qenë më shumë dëshira sesa objektiva të cilat mund të arrihen.

### • **Transparenca e Kuvendit**

Transparenca jo e mjaftueshme e punës së Kuvendit të Kosovës edhe më tutje vazhdon të jetë një nga problemet e mëdha në punën e këtij institucioni. Kuvendi i Kosovës në vend që të ndërmerr veprime të cilat do avanconin transparencën e këtij institucioni, ai po nxjerrë rregullore që edhe më tutje e pengon transparencën e tij. Fakti mjaft shqetësues eshtë Rregullorja për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës, e miratuar nga Kryesia e Kuvendit me 19 prill 2011. Rregulla 10 pika 1 e kësaj Rregullore, u ndalon mediave qëndrimin në seanca plenare më shumë se 15 minutat e para. Në rast se mediat duan ta bëjnë edhe ndonjë fotografi pas kësaj periudhe atëherë duhet nënshtruar procedurave burokratike duke bërë kërkesë në Zyrën për Media dhe Marrëdhënieve me Publikun e cila më pas e dërgon në Zyrën e Sekretarit për aprovim apo refuzim. Ndërkaq pika 7 e po kësaj rregulle eshtë edhe më e ashper ku në mënyrë të qartë ndalon fotografimin dhe video-incizimet nga holli i Kuvendit të Kosovës “Nuk lejohet fotografimi dhe video-incizimet nga holli i Kuvendit” thuhet decidivisht në këtë pikë. Një qasje e tillë tregon për tendencën regresive të Kuvendit në transparencën e këtij institucioni.

Po ashtu edhe në Legjislaturën e IV-të, mbledhjet e Kryesisë së Kuvendit vazhdojnë të mbahen të myllura për organizatat e shoqërisë civile dhe publikun vendor. Mbikëqyrja e punës së Kryesisë aktualisht bëhet vetëm nga organizatat ndërkombëtare të cilat veprojnë në Kosovë siç janë OSBE, NDI dhe ICO. Eshtë kërkesë e vazhdueshme e KDI-së që Kuvendi t'i hapë dyert edhe për organizatat vendore për të rritur transparencën e punës së vet dhe llogaridhëni.

Gjithashtu edhe seancat plenare të Kuvendit të Kosovës edhe më tutje vazhdojnë të transmetohen pjesërisht nga Radio Televizioni i Kosovës RTK, dhe deri më tanë nuk ka as një paralajmërim se diçka mund të ndryshoj. Publikut Kosovar i mohohet e drejta për të përcjellur përfaqësuesit e tyre në Kuvend pas orës 17:00. Ideja për krijimin e një Televizioni Parlamentar i cili do të ishte në shërbim të trupave të Kuvendit, (seancave plenare, komisioneve dhe Kryesisë) edhe pse ishte përkrahur në fillim si ide, ajo ka mbetur vetëm si dëshirë, pasi deri më tanë nuk janë dhënë informata se diçka ka filluar të bëhet në këtë drejtim.

Edhe pas aprovimit të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike i cili ka zëvendësuar Ligjin për Qasje në Dokumentet Zyrtare, që eshtë shumë më i avancuar sesa ai i kaluar i dhe shkuron burokracinë për tu qasur dokumenteve, në Kuvend gjërat nuk kanë ndryshuar. Kur bëhet fjalë për dokumentet të cilat mundë të jenë të ndjeshme për interesat e ndokujt qasja në to eshtë e pa mundur. Në këtë mandat KDI ka hasur në këto probleme Kryesisht në Komisionin për Buxhet dhe Financa ku ka qenë e pa mundur të sigurohen kërkesat buxhetore të agjencioneve të pavarura dhe organizatave të tjera buxhetore që kanë shprehur pakënaqësi lidhur me ndarjet buxhetore.

Disa komisione parlamentare që në fillim dhe në konstituimin e tyre, mbajtjen e mbledhjeve e kanë filluar pa publikimin e orarit të takimeve në faqen elektronike të Kuvendit, duke vepruar kështu në kundërshtim me Rregulloren e cila obligon që mbajtja e mbledhjeve të publikohet qysh më herët.

Publikimi i votave elektronike të deputetëve, edhe pse Rregullorja e Punës në nenin 51 pika e 7 ka precizuar që “Publikimi i votimit elektronik të deputetëve, bëhet brenda tri ditë pune, pas mbledhjes plenare”, fatkeqësisht kjo pothuajse asnjëherë nuk respektohet.

## Rekomandime:

18

- Kuvendi duhet revokoj Rregulloren për Rendin dhe Qasjen e Mediave dhe Publikut në Punën e Kuvendit të Kosovës, e cila u ndalon mediave dhe njerëzve të interesuar që të fotografojnë dhe video-incizojnë në hollin e Kuvendit të Kosovës.
- Qeveria dhe Kuvendi i Kosovës duhet planifikojnë agjendën legislative, në përputhje me kapacitetet që i kanë për procesin e ligjërës.
- Kuvendi duhet të ofroj qasje në mbledhjet e Kryesisë edhe për organizatat vendore të cilat duan ta përcjellin punën e Kryesisë;
- Duhet gjetur alternativa për transmetimin e drejtpërdrejtë televiziv të seancave parlamentare dhe mbledhjeve të komisioneve parlamentare.
- Duhet të respektohet Ligji për Qasje në Dokumentet Publike, i cili garanton qasje në të gjitha dokumentet të cilat nuk janë të klasifikuara si të tilla.
- Votimi elektronik të publikohet, sipas afateve të përcaktuara në Rregulloren e Kuvendit.
- Komisionet parlamentare duhet që për secilin projektligj të organizojnë dëgjime publike
- Të shtohet dhe fuqizohet procesi i monitorimit të zbatimeve të ligjeve
- Kuvendi duhet të gjejë forma për të siguruar që anëtarët e kabinetit qeveritar tu përgjigjen pyetjeve të deputetëve

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR DEPUTETËT E KUVENDIT TË KOSOVËS  
PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2011**

**INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS**

19

Kuvendi i Kosovës				Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. pari apo Komisionit	Ngritura e çështjeve apo propozimeve	Ngritura e çështjeve urgjente	Propozimet përamandamentale	Nismaligjore	Kërkesa për interpelancë	Pyjet parlementare	Mungesat në seanca	Totali
GRUPI PARLAMENTAR PDK	Nr	Deputetët	Subjekti politik	4 pikë	2 pikë	5 pikë	9 pikë	3 pikë	10 pikë	8 pikë	5 pikë	-1 pikë	%
GRUPI PARLAMENTAR LDK	1	ADEM GRABOVCI	PDK	4	16	5	0	0	0	0	0	-2	0.65%
	2	ARSIM BAJRAMI	PDK	24	4	5	0	0	0	0	15	-1	1.34%
	3	AZEM SYLA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	-0.11%
	4	BEHAR SELIMI	PDK	8	8	0	0	0	0	0	0	-2	0.40%
	5	BEKIM HAXHIU	PDK	64	4	25	0	0	0	0	0	-1	2.62%
	6	BERAT BUZHALA	PDK	24	10	10	0	0	0	0	0	-2	1.20%
	7	BLERTA DELIU -KODRA	PDK	24	6	10	0	0	0	0	0	-2	1.08%
	8	ELMI REÇICA	PDK	4	6	0	0	0	0	0	0	0	0.28%
	9	FADIL DEMAKU	PDK	20	4	0	0	0	0	0	0	0	0.68%
	10	FATMIR LIMAJ	PDK	16	0	5	0	0	0	0	0	-9	0.34%
	11	FATMIR XHELILII	PDK	4	4	0	0	0	0	0	0	-2	0.17%
	12	FLORA BROVINA	PDK	8	2	5	0	0	0	0	0	-2	0.37%
	13	GANIMETE MUSLIU	PDK	4	4	5	0	0	0	0	0	-1	0.34%
	14	HALIT KRASNIQI	PDK	32	4	5	0	0	0	0	0	0	1.17%
	15	HASIME KRASNIQI	PDK	8	12	0	0	0	0	0	0	-2	0.51%
	16	HYDAJET HYSENI	PDK	24	0	20	0	0	0	0	0	-3	1.17%
	17	IDRIZ VEHAPI	PDK	8	10	0	0	0	0	0	0	-1	0.48%
	18	JAKUP KRASNIQI	PDK	8	0	0	0	0	0	0	0	-3	0.14%
	19	JUSTINA PULA	PDK	8	0	10	0	0	0	0	0	-4	0.40%
	20	KURTAN KAJTAZI	PDK	8	2	0	0	0	0	0	0	0	0.28%
	21	LATIF GASHI	PDK	8	0	0	0	0	0	0	0	-4	0.11%
	22	LUMNIJE MORINA	PDK	16	2	5	0	0	0	0	0	-3	0.57%
	23	NAHIT HASANI	PDK	32	12	25	0	0	0	0	0	0	1.96%
	24	NIJAZI IDRIZI	PDK	8	8	5	0	0	0	0	15	-1	1.00%
	25	RAMË VATAJ	PDK	8	0	0	0	0	0	0	0	-5	0.09%
	26	RAMIZ LLADROVCI	PDK	24	0	10	0	0	0	0	0	0	0.97%
	27	SAFETE HADERGJONAJ	PDK	0	42	10	0	0	0	0	0	-4	1.37%
	28	SALA BERISHA – SHALA	PDK	16	10	0	0	0	0	0	0	0	0.74%
	29	SALIHE MUSTAFÄ	PDK	12	2	0	0	0	0	0	10	-1	0.65%
	30	SHAIP MUJA	PDK	20	2	5	0	0	0	0	0	0	0.77%
	31	VALBONA DOBRA	PDK	8	10	0	0	0	0	0	0	0	0.51%
	32	XHAVIT HALITI	PDK	8	0	5	0	0	0	0	0	-3	0.28%
	33	XHEVAHIRE IZMAKU	PDK	16	6	5	0	0	0	0	0	-1	0.74%
	34	ZENUN PAJAZITI	PDK	40	36	25	0	0	0	0	0	0	2.88%
	1	AFERDITA BERISHA – SHAQIRI	LDK	28	0	5	0	0	0	0	10	-1	1.20%
	2	ALI SADRIU	LDK	12	16	10	0	0	0	0	0	-1	1.05%
	3	ANTON QUNI	LDK	12	6	5	0	0	0	0	0	-3	0.57%
	4	ARBEN GASHI	LDK	28	0	10	0	0	0	0	0	-5	0.94%
	5	ARMEND ZEMAJ	LDK	28	22	50	0	0	0	0	0	-1	2.82%
	6	BAHRI THAÇI	LDK	4	2	0	0	0	0	0	0	-1	0.14%
	7	EQREM KRYEZIU	LDK	8	0	0	0	0	0	0	0	-1	0.20%
	8	HAKI DEMOLLI	LDK	36	0	25	0	0	0	0	0	-4	1.62%
	9	HASHIM DESHISHKU	LDK	24	2	15	0	0	0	0	0	-1	1.14%
	10	HYKMETE BAJRAMI	LDK	8	10	15	0	0	0	0	0	-2	0.88%
	11	IMRI AHMETI	LDK	20	2	15	0	0	0	0	0	-1	1.02%
	12	ISMET BEQIRI	LDK	24	30	35	0	0	0	0	0	-1	2.50%
	13	LIRIJE KAJTAZI	LDK	8	4	0	0	0	0	0	0	-1	0.31%
	14	LUTTFI HAZIRI	LDK	24	4	10	0	0	0	0	20	-3	1.57%
	15	LUTTFI ZHARKU	LDK	16	16	25	0	0	0	0	0	-1	1.59%
	16	NASER OSMANI	LDK	4	16	0	0	0	0	0	0	-2	0.51%
	17	NAZANE BRECA	LDK	12	0	5	0	0	0	0	0	-4	0.37%
	18	NEKIBE KELMENDI	LDK										
	19	RITA HAJZERAJ – BEQAJ	LDK	16	4	10	0	0	0	0	10	-2	1.08%
	20	SABRI HAMITI	LDK	72	8	20	0	0	0	0	0	-2	2.79%
	21	SADRI FERATI	LDK	4	4	0	0	0	0	0	0	-4	0.11%
	22	SALI ASLLANAJ	LDK	16	2	5	0	0	0	0	0	-2	0.60%
	23	SALIH MORINA	LDK	12	8	10	0	0	0	0	5	-1	0.97%
	24	SKENDER HYSENI	LDK	12	0	5	0	0	0	0	0	-4	0.37%
	25	TEUTA SAHATQIJA	LDK	16	16	15	0	0	0	0	0	-3	1.25%
	26	VJOLLCA KRASNIQI	LDK	4	8	5	0	0	0	0	0	-2	0.43%
	27	VJOSA OSMANI	LDK	12	2	5	0	0	0	0	0	-4	0.43%

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR DEPUTETËT E KUVENDIT TË KOSOVËS  
PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2011**

PA GRUP	G.P. 6+	Kuvendi i Kosovës												Totali
		Nr	Deputetët	Subjekti politik	Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. parl. apo Komisionit	Ngritura e çështjeve apo propozimeve	Ngritura e çështjeve urgjente	Propozimet për amandamente	Nisma ligjore	Kërkesa për interpretancë	Pjetjet parlementare	Mungesa në seanca	
		1	AFRIM HOTI	VV	8	10	15	0	0	0	0	0	-4	0.83%
		2	AFRIM KASOLLI	VV	28	6	15	0	0	0	0	10	-3	1.59%
		3	AGIM KULETA	VV	24	2	5	0	0	0	0	5	-1	1.00%
		4	ALBANA FETOSHI	VV	8	0	5	0	0	0	0	0	-4	0.26%
		5	ALBANA GASHI	VV	4	2	5	0	0	0	0	0	-1	0.28%
		6	ALBIN KURTI	VV	16	6	20	0	0	0	0	0	-3	1.11%
		7	ALBULENA HAXHIU	VV	8	14	15	0	0	0	0	5	-2	1.14%
		8	ALMA LAMA	VV	36	10	20	0	0	0	0	10	-2	2.11%
		9	AURORA BAKALLI	VV	16	4	5	0	0	0	0	0	-1	0.68%
		10	FLORIN KRASNIQI	VV	16	0	5	0	0	0	0	0	-10	0.31%
		11	GLAUK KONJUFCA	VV	36	8	15	0	0	0	0	0	0	1.68%
		12	LIBURN ALIU	VV	40	10	35	0	0	0	0	5	-3	2.48%
		13	REXHEP SELIMI	VV	16	22	15	0	0	0	0	0	-1	1.48%
		14	VISAR YMERI	VV	16	58	50	0	0	0	0	10	0	3.81%
		1	AHMET ISUFI	AAK	8	12	5	0	0	0	0	0	-2	0.65%
		2	ARDIAN GJINI	AAK	24	62	65	0	0	0	0	0	-1	4.27%
		3	BALI MUHAREMAJ	AAK	4	6	5	0	0	0	0	5	-2	0.51%
		4	BLERIM SHALA	AAK	16	4	25	0	0	0	0	0	-2	1.22%
		5	BURIM RAMADANI	AAK	16	14	15	0	0	0	0	0	-3	1.20%
		6	DAUT HARADINAJ	AAK	8	2	10	0	0	0	0	0	-1	0.54%
		7	DONIKA KADAJ – BUJUPI	AAK	16	14	25	0	0	0	0	5	-2	1.65%
		8	KYMETE BAJRAKTARI	AAK	4	2	10	0	0	0	0	0	-1	0.43%
		9	RAMIZ KELMENDI	AAK	8	0	10	0	0	0	0	0	-4	0.40%
		10	TEUTA HAXHIU	AAK	28	14	20	0	0	0	0	5	0	1.91%
		11	XHEVDET NEZIRAJ	AAK	16	10	10	0	0	0	0	10	-1	1.28%
		12	TIME KADRIJAJ	AAK	12	10	0	0	0	0	0	25	-1	1.31%
		1	SAŠA RAŠIĆ	SLS										
		2	JELENA BONTIĆ	SLS	0	10	10	0	0	0	0	0	-1	0.54%
		3	PETAR MILETIĆ	SLS	0	8	5	0	0	0	0	0	-7	0.17%
		4	JASMINA ŽIVKOVIĆ	SLS	0	4	0	0	0	0	0	0	-1	0.09%
		5	SAŠA MILOSAVLJEVIĆ	SLS	0	24	0	0	0	0	0	0	-1	0.65%
		6	VESIMIR SAVIĆ	SLS	0	2	0	0	0	0	0	0	0	0.06%
		7	BISERKA KOSTIĆ	SLS	0	8	5	0	0	0	0	0	0	0.37%
		8	ETEM ARIFI	SLS	0	0	0	0	0	0	0	0	-1	-0.03%
		9	SAŠA ĐOKIĆ	SLS	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
		10	GORAN MARINKOVIĆ	SLS	0	10	0	0	0	0	0	0	-2	0.23%
		11	BOBAN TODOROVIĆ	SLS	0	0	0	0	0	0	0	0	-1	-0.03%
		12	MURSELJ HALJILJI	SLS	0	14	0	0	0	0	0	0	-4	0.28%
		1	AMIR AHMETI	KKR	4	10	20	0	0	0	0	0	-1	0.94%
		2	GEZIM KELMENDI	KKR	20	10	10	0	0	0	0	0	-2	1.08%
		3	IBRAHIM MAKOLLI	KKR										
		4	JETON SVIRCA	KKR	0	6	0	0	0	0	0	0	-2	0.11%
		5	MUHAMET MUSTAFÄ	KKR	24	10	15	0	0	0	0	0	-1	1.37%
		6	MYZEJENE SELMANI	KKR	16	54	10	0	0	0	0	0	0	2.28%
		7	SEVDIJE LAMA	KKR	4	8	5	0	0	0	0	0	0	0.48%
		8	SUZAN NOVOBRDALIU	KKR	4	16	5	0	18	0	0	0	-5	1.08%
		9	UKË RUGOVA	KKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
		1	RASIM DEMIRI	6+	0	16	0	0	0	0	0	0	-2	0.40%
		2	ENIS KERVAN	6+	0	6	0	0	0	0	0	0	-1	0.14%
		3	DUDA BALJE	6+	8	26	0	0	0	0	0	0	-1	0.94%
		4	ALBERT KINOLLI	6+	0	26	0	0	0	0	0	0	-1	0.71%
		5	MÜFERA ŞİNİK	6+	4	6	0	0	0	0	0	0	-4	0.17%
		6	FIKRIM DAMKA	6+	4	16	0	0	0	0	0	0	-3	0.48%
		1	HAMZA BALJE	-	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0.00%
		2	VESNA MIKIĆ	-	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	-0.11%
		3	EMILIJA REDŽEPI	-	4	0	0	0	0	0	0	0	-2	0.06%
		4	RADA TRAJKOVIĆ	-	8	0	0	0	0	0	0	0	-9	-0.03%
		5	SREȚEN IVANOVIĆ	-	0	0	0	0	0	0	0	0	-4	-0.11%
		6	DANUSH ADEMI	-	0	0	0	0	0	0	0	10	0	0.28%

## REZULTATET E NOTIMEVE PËR SUBJEKTE POLITIKE

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seancë			Pjesëmarrja në diskutime	Diskutimet në emër të gr. parl. apo Komisionit	Ngritura e sëshijeve apo propozimeve	Ngritura e sëshijeve urgjente	Propozimet për amandamente	Nisma ligjore	Kërkesa për interpellancë	Pvjetjet parlamentare	Mungesat në seancë	Totali
Nr	Subjekte politike	Numri i anëtarëve										
1	PDK	34	516	226	200	0	0	0	0	40	-63	25.7%
2	LDK	27	444	172	290	0	0	0	0	45	-51	25.1%
3	LVV	14	288	162	235	0	0	0	16	45	-41	20.8%
4	AAK	12	160	150	200	0	0	0	0	50	-20	15.1%
5	SLS	12	0	102	20	0	0	0	0	0	-18	2.9%
6	KKR	9	72	128	65	0	18	0	0	0	-15	7.5%
7	6+	6	16	96	0	0	0	0	0	0	-12	2.8%
8	PA GRUP	6	12	0	0	0	0	0	0	10	-19	0.1%

## ANALIZA KRAHASUESE E DEPUTETËVE

### Deputetët më aktiv gjatë kësaj periudhe parlamentare

1. Ardin Gjini	4.27 %
2. Visar Ymeri	3.81 %
3. Zenun Pajaziti	2.88 %
